

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**DALLIMET NË DISA KARAKTERISTIKA**  
**ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE NDËRMJET TË**  
**RINJËVE TË MOSHES 13-14 VJEÇ**

**MENTORI:**

**Prof.Dr. Naser Rashiti**

**KANDIDATET:**

**Arta Berisha**

**Fatbardha Berisha**

**Prishtinë, 2019**

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	3
2. HULUMTIMET E DERITASHME.....	8
3. QËLLIMI PUNIMIT .....	13
4. HIPOTEZAT THEMELORE .....	14
5. METODOLOGJIA E PUNËS .....	15
5.1 MOSTRA E TË TESTUARVE .....	15
5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	16
5.2.1. Ndryshoret antropometrike .....	16
5.2.2 Ndryshoret motorike bazike.....	16
5.2.3 Ndryshoret motorike specifike.....	16
5.3 TEKNIKAT E MATJES.....	17
5.3.1 Teknika e matjeve të karakteristikave antropometrike .....	17
5.3.2 Teknika e matjeve të aftësive motorike bazike .....	23
5.3.3 Teknika e matjeve të ndryshoreve specifike motorike.....	28
5.4 METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE.....	30
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI.....	31
6.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SPECIFIKE TE FëmIJËT E MOSHËS 13 VJEÇ .....	31
6.2. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SPECIFIKE TE FëmIJËT E MOSHËS 13 VJEÇ .....	45
6.3 REZULTATET E NDËRLIDHJEVE.....	59
6.4 DALLIMET NË REZULTATET E VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE DHE MOTORIKE-SPECIFIKE .....	61
6.5 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	62
7. PËRFUNDIMI .....	63
8. LITERATURA .....	65

## 1.HYRJE

Hulumtimi është zbatuar me qëllim të përcaktimit të dallimit të disa karakteristikave antropometrike, motorike dhe specifiko-motorike në mes nxënësve të moshës 13-14 vjeçare të gjinise mashkullore. Në mostër janë përfshirë 100 nxënës të përfshirë në seksionin e atletikës në kuadër të shkollës përpos orëve të rregullta të edukatës fizike nuk janë marr me ndonjë aktivitet sportiv. Gjithsejtë në hulumtim janë përfshirë 100 nxënës që janë testuar gjatë periudhës kohore shkollore shtator të vitit 2019.

Atletika është një ndër sportet më të vjetra në botë, sport i cili daton si një sport që në mijëvjeçarin e dytë para erës sonë. Atletët ishin pjesë e privilegjuar e popullsisë që gëzonin respektin e të tjerëve dhe ishin pjesë e hierarkisë më të lartë të qytetërimit antik. Sot atletika numëron një numër të madh disiplinash, në antikë atletika ishte e kushtëzuar më vrapime të ndryshme dhe hedhje disku. Gjatë kohës së antikës dhe sidomos erës romake dhe helene shumë sporte që sot paraqiten si sporte në vete (mundja, noti etj) i atribuoheshin sportit të atletikës. Në këtë sport hyjnë disiplinat të bazuara në lëvizjet natyrore siç ishte vrapimi, kërcimi, gjuajtjet dhe hedhjet të cilat mund të ekzekutohen në gara nga një atlet, nga më shumë atletë apo ekipe atletësh.

Janë një varg arsyesish që më nxitën që të merrem me procesin e edukimit fizik-atletikor. Procesi i të mësuarit të disiplinave atletikore nis herët (rreth moshës 7-8 vjeç), kur fëmija arrin një nivel të caktuar të treguesve lëvizorë dhe koordinative, që ndihmojnë atë në përshkrimin e veprimeve lëvizore të ndryshme. Bazat metodike dhe organizative të tij hidhen në shkollë gjatë aktivizimit sistematik në orën e edukimit fizik, me temë atletikore. Ajo zhvillohen më tej me veprimtari të ndryshme lëvizore, veçanërisht në kuadrin e lojërave zbavitëse, në përbërje të cilave zhvillohen natyrshëm ushtrimet e ecjes, vrapimit, kërcimit dhe të hedhjes së sendeve të ndryshme.

Fakti se proceset e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve paraqesin procese mjaftë komplekse dinamike, të cilat vazhdimisht i nënshtrohen kombinimit të faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm, shtron nevojën e vërtetimit të ndikimeve të tretmanëve të caktuar lëvizore në rritje dhe zhvillim sa më harmonik. Moshë e përzgjedhur në hulumtim i takon fazës së pubertetit, ku më shumë se 90% e fëmijëve të kësaj moshe përjetojnë ndryshime strukturale dhe funksional si

rezultat i veprimit të hormoneve të caktuara seksuale, të cilat afektojnë edhe zhvillimin e përgjithshëm trupor dhe intelektual, dhe në masë të madhe ndikojnë edhe në manifestim të aftësive lëvizore. Vërtetimi i ndryshimeve në mes të grupmoshave 12, 13 dhe 14 vjeçare do të paraqes një tregues të dinamikës së lëvizjes progresive, në kuptimin e ngritjes së aftësive lëvizore.

Vrapimi është një mjet bazë për përgatitjen fizike dhe zhvillimin e organizmit. Ai ndihmon për të përballuar ngarkesa stërvitore të larta. Vrapimi është mjet më universal për përgatitjen e gjithanshme të atletit, por ai zë një vend tepër të rëndësishëm edhe në stërvitjen e llojeve të tjera të sportit. Gjatë vrapimit, organizmit i paraqiten shumë kërkesa ndaj punës së sistemit muskolor, veprimtarisë vazo kardiake dhe të frymëmarrjes. Ai përbën një mjet të rëndësishëm për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit.

Testet e shpejtësisë, të cilat masin aftësinë e organizmit për ekzekutim të lëvizjeve me shpejtësi maksimale e që në rastin tonë janë testuar me anë të vrapimeve 40 dhe 60 metra, paraqesin një tregues mjaftë të fuqishëm të nivelit të funksionimit të strukturave bartës të sistemit lokomotorë. Me anë të këtij punimi, do të bëhet përpjekje të identifikohet madhësia dhe roli i ndikimit që kanë dimensionet e koordinimit në manifestimin e rezultatit të vrapimeve në shtigje të shkurta të cilat do të testohen me anë të testeve vrapim 60 metra dhe vrapim 80 metra nga

Koordinimi është aftësitë bazike motorike e cila për nga specifikat dallon në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me aftësi të tjera motorike. Besohet se koordinimi është aftësi motorike më e hulumtuara deri më tani. Përkundër këtij fakti, me anë të treguesve të saj të tërthortë, faktorët e saj mund të tregojnë nivelin e zhvillimit të këtij dimensionit. Faktorët më të rëndësishëm të koordinimit janë: mosha, faktorët kognitive, përvoja e mëparshme lëvizore, gjendja emocionale, përqendrimi i vëmendjes dhe motivimi.

Hapësira antropologjike është hapësirë shumë dimensionale, interaktive dhe se për këtë arsye do të përcaktohem që veçanërisht ti përshkruajmë ato modele teorike të nën hapësirës relevante të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e sukseseve në sportin apo disiplinat e atletikës. Karakteristikat morfologjike (dimensionet) duhet ti kuptojmë si esencën biologjike dhe fiziologjike e cila gjeneron manifestimin e karakteristikave antropometrike sikur që janë: lartësia e trupit, pesha, perimetri i trupit dhe ekstremiteteve, gjatësitë dhe gjerësitë e kockave, trashësia e

indit dhjamor e tjera. Me këto karakteristika definohet rrita dhe zhvillimi i fëmijëve dhe i rinisë, si dhe ndërtimi trupor i tyre (konstitucioni) edhe atë ashtu që me këto vërtetohet struktura e karakteristikave morfologjike (Bala, 2007).Ndërtimi trupor (konstitucioni, somatotipi) është karakteristika më e dukshme e njeriut. Tek të rriturit kjo ka lidhje me sjelljet gjatë jetës, profesionin, sëmundjen, aktivitetin sportiv dhe suksesin. Njohurit dhe studimi i ndërtimit trupor gjatë rritës dhe zhvillimit mundëson që ta kuptojmë më mirë variacionin e konstitucionit të njeriut.

Përcaktimi dhe definimi i konstitucionit trupor i fëmijëve dhe i të rriturve është i vështirë të ekzekutohet, sepse ata ende nuk kanë karakteristika stabile referente, sidomos gjinia femërore. Disa metoda kërkojnë karakteristika stabile dhe fikse (psh. somotipet e Sheldonit). Zhvillimi dhe rrita e ndryshme e karakteristikave morfologjike dhe indeve (sidomos e indit dhjamor nën lëkuror) shpejt ndryshon proporcionet trupore, çka në mënyrë të rëndësishme ndikon në besueshmërinë e definimit të konstitucionit trupor të fëmijët dhe të rriturit.

Ligjshmëritë e rritjes së fëmijëve dhe të rinisë mund të thjeshtësohen dhe të sumohen në tri veçori\*:

- a) intensiteti i rritjes i disa organeve nuk është i njëjtë;
- b) rritja nuk është lineare, por tregon periudha të intensitetit më të shpejt ose më të ngadaltë;
- c) organet gjatë rritjes nuk rrisin vetëm masën e tyre por ndryshojnë edhe strukturën e tyre.

Gjatë rritjes së rinisë është i dukshëm ndryshimi kontinuel i lartësisë së trupit e cila zgjatë kryesisht deri në moshën 20 vjeçare, edhe pse formimi dhe rritja përfundimtare e kockave përfundon pas moshës 23 vjeçare. Mekanizmi fiziologjik i rritjes dhe formimit të kockave praktikisht është i njëjtë për të gjithë skeletin. Përpos indit kockor edhe indet e buta (muskujt) rriten dhe zhvillohen njëkohësisht.

Me dimensione motorike nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme në të gjitha sportet (pra, edhe në sportin e atletikës), pa marr parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të trajningut apo jo. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapësi vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Me aplikimin e

---

\*Sipas Radovan Medveditme bashkëpunëtor, 1987.

analizës faktoriale zbulohen gjithë e më shumë faktor të cilët vërtetojnë ekzistimin e shumë faktorëve motorik siç janë: të forcës, shpejtësisë, koordinacionit, fleksibilitetit, dhe tjerë e dhe tjerë e që ka sjellur deri te pyetja se sa dimensione motorike objektivisht ekzistojnë dhe çfarë është raporti ndërmjet tyre. Në bazë të hulumtimeve të cilat kanë pasur karakter taksonom në strukturën e hapësirës motorike (faktor të rendit të parë) janë definuar faktor të tipit akcional (forca ,shpejtësia, fleksibiliteti, drejtpeshimi, kordinacioni dhe preciziteti) dhe faktor të tipit topologjik ( forca e matur me dinamometër, forca eksplozive, forca repetitive e duarve dhe e kraharorit, forca repetitive e këmbëve, forca repetitive e trupit, forca statike e duarve dhe e kraharorit, forca statike e këmbëve, forca statike e trupit, të vërejturit preciz, gjuajtja precize, drejtpeshimi me sy të mbyllur, drejtpeshimi me sy të hapur, fleksibiliteti, shpejtësia e lëvizjeve të thjeshta, shpejtësia e frekvencionit, shpejtësia e të mësuarit të detyrave të reja motorike, koordinimi në ritëm, agjiliteti, riorganizimi stereotip i lëvizjeve, shpejtësia e ekzekutimit të detyrave komplekse motorike, koordinimi i tërë trupit, koordinimi i duarve, koordinimi i këmbëve).

Shumica e aftësive psikomotorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmirisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike ndërsa pas periudhës së pubertetit (15 – 18 vjeçare) fillonë të stabilizohet (Metikos, 1974, Kurelic me bashk., 1975, Bala, Kis dhe Popovic, 1996).

Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar (Duraskovic, 2002).

Sporti kulmor sot bënë pjesë në grupin e sporteve anaerobe dhe aerobe. Aktiviteti i atletit bazohet në aftësitë e përgjithshme motorike, të cilat i mundësojnë arritjen e njohurive në elementet specifike, situaciono tekniko-taktike, relevante për arritjen e suksesit në sportin e atletikës (Bojic me bashk., 2007).

Orientimi dhe përcaktimi i rinisë për sportin e atletikës është i kushtëzuar me dëshirën e vet të riut për këtë sport ose me anë të seleksionimit nga ana e ekspertit të lojës së hendbollit duke i marr parasysh karakteristikat morfologjike për këtë sport, aftësitë psikomotorike dhe kognitive si dhe shpejtësinë e të mësuarit dhe përsosjes së elementeve tekniko-taktike, (Fulgozi,

1994). Selektionimi, përpos zgjedhjes që duhet bërë, nënkupton edhe orientimin dhe përsosjen e atletëve talent dhe sportistëve potencial kulmor (Paranosic dhe Savic, 1977). Ky është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar i cili kërkon punë ekipore dhe qëndrim multi disiplinor.

Atletika sipas karakteristikave të tyre i përket lëvizjeve ciklike monostrukturale ciklike apo aciklike, dhe numërohet në kategorinë e sporteve atraktive. Suksesi në të gjitha sportet, pra edhe në atletikë, varet nga shumë faktorë ndërmjet veti të lidhura ndërmjet veti siç janë: aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, strukturës motivuese, karakteristikave fiziologjike-funksionale, dinamika e rrethit mikrosocial, elementeve tekniko-taktike, si dhe struktura morfologjike e atletit. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në sportin e atletikës.

Në këtë kontekst është i mundur përcaktimi i rolit të dimensioneve morfologjike dhe aftësive situaciono-motorike si subsistem i sportit (si sistem), dhe si komponentë programore e procesit transformues (Demir, 1998). Udhëheqja me këto procese është e mundur nëse në to në mënyrë konstante funksionon lidhja ndërmjet çdo nënsistemi (Gabrieliçi, 1977).

Karakteristikat e sportit të atletikës janë lëvizjet shumë të shpejta me lëvizje eksplozive dhe të shumëfishta ciklike dhe aciklike të cilat kërkojnë aftësi komplekse të atletit dhe shkallë të lartë të aftësive koordinuese, funksionale dhe kognitive të cilat janë baza e aksioneve të forta të shpejta dhe precize. Situatat e ndërlikuara gjatë garës kërkojnë atlet të përgatitur, të aftë që detyrat tekniko-taktike gjatë garës në mënyrë precize, me intensitet dhe kohë optimale ti realizojë.

## 2. HULUMTIMET E DERITASHME

Kohëve të fundit është në rritje numri i punimeve nga autorë të ndryshëm në trajnimin e hapësirës së aftësive motorike në popullatën e të rinjve të moshave të ndryshme. Në trevat tona hulumtimet në popullatat e të rinjve, pavarësisht nga tretmani kineziologjik është ende i vogël, e në shumicën e hulumtimeve deri më tani kjo problematikë është trajtuar në mënyrë segmentare. Hulumtimet e kohës së fundit në hapësirën morfologjike flasin për ekzistimin e së paku katër dimensioneve latente: dimensionin i rritjes longitudinale të skeletit, dimensionin i rritjes transversale të skeletit, dimensionin i masës dhe vëllimit të trupit dhe dimensionin i indit dhjamor nënlëkuror të trupit. Hulumtimet në trevën tonë janë orientuar më tepër në fushat e morfologjisë dhe motorikes, ku kanë shqyrtuar strukturën faktoriale, lidhshmëritë dhe ndikimet e këtyre fushave me dukuritë e sporteve të ndryshme. Në shumë hulumtime të deritashme, në mostra të popullatës shkollore, është vërtetuar ekzistimi i dimensioneve antropometrike dhe motorike, por që ato ndryshojnë në varshmëri nga mostrat përkatëse. Në dy dekadat e fundit ekziston një numër relativisht i madh i eksperimenteve me nxënës të grupmoshave të ndryshme, sidomos të atyre prej 10 – 14 vjeç. Megjithatë, në bazë të literaturës që kanë shfrytëzuar, në vijim do të përshkruajmë disa hulumtime të cilat si objekt studimi kanë pasur vërtetimin e karakteristikave morfologjike dhe si dhe relacionet e tyre me aftësitë motorike të nxënësve në mostra përfaqësive të njëjta, me mostrën e këtij hulumtimi

**Skender (2002)** në një mostër prej 160 të anketuarve 3 dhe klasën e 4 Shkolla fillore është përpjekur për të përcaktuar se çfarë lloj të efekteve mund të arrihet duke përdorur ushtrimet bazike motorike, aftësitë funksionale dhe karakteristikat morfologjike, me përdorimin e ushtrimeve të ndryshme nga atletika, gjimnastika dhe lojërat sportive. Për vlerësimin e aftësive motorike elementare (shpejtësi, koordinimit, fleksibilitet, të përsëritura dhe forca eksplozive) u aplikuan 21 variabla. Autori arrin në përfundimin se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në fushën e aftësive bazike motorike dhe aftësitë funksionale.

**Deblonogić (2003)** ka hulumtuar nivelin e ndryshimeve kuantitative dhe kualitative në vrapimet në shtigje të shkurta dhe ndikimit të tyre në sporte të ndryshme. Hulumtimi i cili ka pasur karakter longitudinal ku janë aplikuar 12 variabla antropometrike 16 teste motorike dhe vrapimet në 60 dhe 100 metra është kryer në mostrën prej 173 nxënësve të shkollave fillore të



moshës 15 vjeçare. Hulumtimi tregon se procesi stërvitor ndikon dukshëm në përmirësimin e karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike e me këte edhe rritjen e shpëtësisë së vrapimit.

**Metikoš et al ( 2003)** përcaktojnë koordinimin psikomotorik si " koordinimin i cili zhvillohet me mësimin dhe shumëllojshmërinë e lëvizjeve të reja dhe me përsëritjen e ushtrimeve të mësuara më parë. Ushtrimet e koordinimit kërkojnë koncept më të lartë dhe në të ndikon një numër i madh i faktorëve. Përveç inteligjencës, stërvitjes sistematike dhe lëvizjeve të përvetësuara më herët në koordinim ndikon edhe niveli i aftësive tjera motorike. Niveli i lartë i shpejtësisë, forca, qëndrueshmëria dhe fleksibiliteti në mënyrë pozitive do të ndikojnë edhe në nivelin e koordinimit. Po ashtu edhe niveli i lartë i koordinimit ka transfero pozitive në aftësitë tjera motorike.

**Spanović me bp. (2009)** në një mostër të 707 djemve të moshës nga 9 deri në 15 vjet ( MA = 11.8 dhe DS = 1.64 ), të ndarë në gjashtë kategori të ndryshme, është përcjell zhillimi i koordinimit në fazën kritike të koordinimit. Autorët kanë ardh në përfundim se, edhe pse në spektrin gjeneral, testet e masin koordinimin, secili nga këto teste e ka edhe nën dimensionin e vetë. Autorët kanë vërtetuar se lineariteti i cili ekziston në dimensionin e koordinimit para fazës së pubertetit dukshëm prishet gjatë kësaj faze .

**Rashiti (2011)** në hulumtimin e tij ku janë përfshirë 173 nxënës të dy gjinive të ndarë në grupe të barabarta që pa pasur qëllim përcaktimin e lidhshmërisë ndërmjet aftësive motorike dhe disiplinave të atletikës në distanca të shkurta dhe të mesme si dhe ndikimin e vrapimeve në distanca të ndryshme. autori ka ardhur në përfundim se rezultatet e firmuara tregojnë për ekzistimin e ndikimit mesatar të variablave motorike në vrapimin 1000 metra. Punimet në këtë sub hapsirë kryesisht janë parciais, me numër të vogël mostrash dhe të variablave. Studimi i kësaj problematike ka për qëllim njohjen sa më të mire të faktorëve të ndryshëm të zhvillimit morfologjik, dhe motorik në përcaktimin dhe njohjen sa ma të mire në realizimin e suksesshëm të teknikës së shtytjes së gjyles. Njëkohësisht, ky dhe hulumtimet e tilla duhet të paraqesin nxitje në përpjekjet e mëtutjeshme të studimeve të ardhshme në këtë hapësirë. Duke e zhvilluar punën hulumtuese në një nivel më të lartë dhe hapësirë më të gjer mund të priten gjithmonë njohuri të plota dhe complete. Në këtë rrugë, shpresojmë se, edhe ky punim do të paraqes një nga shkallët e zhvillimit.

**Sahiti** (2012) sipas autorit qëllimi bazik i hulumtimit del nga lemia dhe problemi i parashtruar i hulumtimit që është i orientuar në zbulimin e faktorëve morfologjik dhe motorik si dhe ndikimin të këtyre së bashku në ekzekutimin e detyrës teknike në atletikë, konkretisht në shtytjen e gjyles të nxënësit të shkollave fillore të lartë të komunës së Gjilanit. Popullata nga e cila është nxjerrë mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullat e nxënësve të Shkollës Fillore “Selami Hallaqi” nxënës të rregullt të klasave të nënta të gjinisë mashkullore të Komunës së Gjilanit. Në këtë hulumtim janë përfshirë gjithsej 100 nxënës të klasave të nënta të moshës  $15 \pm 6$  vjeçare e që janë testuar gjatë periudhës kohore shkollare mars – prill të vitit 2011. Në këtë punim janë aplikuar dhjetë variabla antropometrike, gjashtë teste motorike dhe një parametër i disiplinës së atletikës- shtytja së gjyles. Përcaktimi i shkallës së ndikimit të variablave predikatore në ato kriterike është aplikuar analiza regresive. Rezultatet e fituara nga përpunimi i tyre tregojnë se edhe pse zhvillimi i disa parametrave antropometrik dhe motorik është nën ndikimin e faktorit gjenetik mund të ndikohet me anë të ushtrimeve që të kenë zhvillim më të mirë. Varësisht nga lojërat sportive, ushtrimet specifike ndikojnë në mënyrë specifike në ndërtimin e jashtëm të trupit të njeriut. Këtë duhet pasur parasysh gjithmonë se çdo disiplinë e atletikes i ka teknikat e veta të ekzekutimit si dhe strukturën specifike të lëvizjes, prandaj edhe ushtrimet për arritjen e rezultateve më të mira dhe kulmore në ato disiplina (konkretisht në shtytjen e gjyles) duhet ti shfrytëzojnë mjetet specifike si dhe metodat më bashkëkohore të procesit stërvitor.

**Xhemajli (2012)** si qëllim kryesor të hulumtimit e kishte përcaktimin e shkallës së dallimit ndërmjet dy grupeve, respektivisht, ndërmjet grupit të nxënësve dhe atletëve në disa karakteristika antropometrike, motorike dhe specifike motorike. Qëllimi dytësorë i këtij hulumtimi ishte përcaktimi i shkallës së ndikimit të karakteristika antropometrike dhe motorike në realizimin e detyrave motorike specifike (vrapimit në distanca të shkurtra). Hulumtimi ka përfshirë 60 atlet dhe 60 nxënës. Gjithsej në hulumtim janë përfshirë 120 nxënës të moshës 15 vjeçare. Janë aplikuar 10 parametra antropometrik, 6 teste motorike dhe 2 teste specifike-motorike. Për gjitha grupet e sistemit të variablave janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale, dhe analiza diskriminative T-testi. Rezultatet e punimit tregojnë se procesi stërvitor në orët shtesë në kuadër të seksionit të atletikës ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe transformimin

pozitiv dhe të përgjithshëm të trupit në aspektin e zhvillimit morfologjik, motorik dhe specifike-motorike çka u vërtetuar me ndryshimet e ndodhura te grupi i nxënësve atlet.

**Jonida (2014)** Hulumtimi i realizuar me grupmoshat e meshkujve 12, 13 dhe 14 vjeçar, në mostrën e tërësishme prej 150 nxënësve, ( 6 subostrat me nga 25 nxënës) i orientuar kryesisht në zbulimin e lidhmëris e cila ekziston në mes të dimensionit të koordinimit të matur me 6 teste të standardizuar si dhe zbulimit të mundësisë së parashikimit të rezultatit tek vrapimet e distancave 60 dhe 80m nga sistemi i prediktorëve të testeve të koordinimit. Qëllimi i hulumtimit ka qenë i orientuar në vërtetimin e ndikimit të disa aftësive motorike, sidomos të aftësive të koordinimit në realizimin e dy detyrave motorike specifike të atletikes, konkretisht të dy testeve të vrapimit të shpejtësisë, vrapimin 60 m dhe vrapimin 80m. Punimi është përmbledhur në vërtetimin e 3 hipotezave të cilat është arritur të vërtetohen me anë të metodave të korrelacionit, analizës regressive si dhe metodës së analizës univariante të variancës – Anovës. Pas aplikimit të gjitha procedurave është arritur deri tek përfundimet nga të cilat edhe mundë të nxirren këto konkludojmë se shumica e testeve të koordinimit kanë pasur lidhmëri të lartë statistikor me shumicën e testeve motorike . Në shumicën e rasteve ndryshimet kanë qenë në të mirë të djemve dhe vetëm në njërin rast janë paraqitur ndryshime në të mirë të vajzave. Ky ndryshim ka ndodhur në testin e vrapimit 80 metra, ku vajzat kanë realizuar rezultat më të mirë, ndryshim ky i cili ka qenë ndryshim i rëndësishëm statistikorë. vërtetimit të ndikimit të rëndësishëm statistikor i variablave të koordinimit në nivelin e manifestimit të rezultatit final në vrapimin e shpejtësisë është vërtetuar plotësisht pasi që në të gjitha grupmoshat dhe në të dy gjinitë lidhmëria regressive e testeve të koordinimit si sistem prediktorësh është treguar e rëndësishme në parashikimin e rezultateve të vrapimeve të shpejta 60 dhe 80 metra.

**Baftiu (2018).** Thekson se hulumtimi është zbatuar me qëllim të përcaktimit të dallimit të disa karakteristikave antropometrike, motorike dhe specifiko-motorike në mes të nxënësve të viseve urbane dhe nxënësve të viseve rurale të moshës 15 vjeçare. Në mostër janë përfshirë 60 nxënës të viseve urbane dhe 60 nxënës të viseve rurale. të përfshirë në seksionin e atletikës në kuadër të shkollës dhe 60 nxënës që përpos orëve të rregullta të edukatës fizike nuk janë marr me ndonjë aktivitet sportiv. Gjithsejtë në hulumtim janë përfshirë 120 nxënës) që janë testuar gjatë periudhës kohore shkollore shtator të vitit 2018. Të gjitha variablat e përdorura antropometrike, motorike dhe specifike-motorike iu janë nënshtruar përpunimeve themelore

statistikore, në bazë të së cilës është vërtetuar se të gjitha testet kanë karakteristika metrike të kënaqshme. Dallimi në mes mesatareve aritmetikore të rezultateve të grupeve të hulumtuara është përcaktuar me anë të analizës diskriminative T-testit. Rezultatet e fituara nga përpunimi i tyre tregojnë se dallime të rëndësishme statistikore në mesatare aritmetikore në mes të nxënësve të viseve urbane dhe nxënësve të viseve rurale janë fituar në variablat: Gjatësia e krahut (AGJAKR), Pësia e trupit (AGJAKR) Vrapimi 60 metra nga starti ulët (MV60SL), Vrapimi 80 metra nga starti ulët (MV80SL) Vrapimi 100 metra nga starti ulët (MV100SL). Mund të theksojmë se zhvillimi i shpejtësisë ose i vrapimeve në distanca të shkurtëra është nën ndikimin e faktorit trashëgues, me ushtrime dhe procese stërvitore të organizuara mirë mund të ndikohet pozitivisht në rritjen e saj.

**Berisha me bp. (2019)** thekson se në aftësitë motorike mund të veprojmë në dy mënyra, respektivisht mund të zhvillojmë në mënyrë analitike duke e zhvilluar çdo njëren veç e veç ose zhvillimin sintetik dhe zhvillimi bashkues i shumë aftësive në përgatitjen e përbashkët kondicionale. Qëllimi gjeneral i punimit ishte që të vërtetohet dallimi në mes atletëve dhe karateistëve në disa aftësi motorike, respektivisht të vërtetohet ndikimi i ushtrimeve të karates dhe ushtrimeve të atletikës në disa aftësi motorike esenciale për arritjen e rezultateve të mira në çdo sport. Në realizimin e qëllimit të punimit janë përfshirë 30 atletë dhe 30 karateist të moshës 12 vjeçe. Për të vërtetuar ndikimin e ushtrimeve specifike të atletët dhe karateistët janë aplikuar nëntë teste motorike: Vrapim 30 m starti i lartë (MV30ML), Taping me këmbë (MTAKËM), Taping me dorë (MTADOR), Tetëshja me përkulje (MTEPËR), Hapa anash (MHAANA), Katërkëndëshi (MKATKË), Fleksibiliteti për kulje para (MFLPPA), Fleksibiliteti ulur me këmbë anash (MFLUKA) dhe Hedhje e topit medicinal nga pozita ulur (MFEHTU). Analiza diskriminative tregon se ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes atletëve dhe karateistëve të përfshirë në orët e rregullta të edukatës fizike dhe seanca stërvitore specifike në disa aftësi motorike.

### 3. QËLLIMI PUNIMIT

Problemi i cili trajtohet në këtë punim është sa i rëndësishëm aq edhe aktual, sepse në të gjitha sportet të karaktereve të ndryshme hulomtuese, pra edhe në sportin e atletikës ndihet gjithë e më tepër nevoja për objektivizmin e treguesve të ndikimit të ushtrimeve fizike e sidomos të vrapimeve në distanca 40 dhe 60 meta, që në mënyrë të sigurt dhe efikase mundë të diagnostifikojmë, programojmë, që në mënyrë direkte të udhëheqim dhe kontrollojmë proceset transformuese në sportin e atletikës dhe lëndën e edukimit fizik në shkollat tona.

Qëllimi kryesor i këtij hulomtimi është përcaktimi i dallimit në mes nxënësve të moshës 13 dhe 14 vjeçare, respektivisht ndërmjet grupit të nxënësve 13 dhe 14 vjeçare të gjinisë mashkullore nga shkolla "Zejnel Salihu" Fushë Kosovë dhe të vërtetohen dallimet në mes këtyre dy grupe (moshave të nxënësve) në disa karakteristika antropometrike, motorike dhe specifike motorike.

#### **4. HIPOTEZAT THEMELORE**

Në bazë të problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

**H<sub>01</sub>**- Supozojmë se rezultatet e variablave antropometrike, motorike bazike dhe vrapimeve në distanca të shkurtëra si ndryshore motorike specifike te dy grupet e fëmijve (13 dhe 14 vjeçare) dotë jenë homogjene dhe statististikisht të rëndësishme.

**H<sub>02</sub>**- Supozojmë rezultatet e variablave antropometrike, motorike bazike dhe vrapimeve në distanca të shkurtëra te dy grupet e fëmijve (13 dhe 14 vjeçare) si ndryshore motorike specifikedo të kenë koeficiente të korrelacionit statististikisht të rëndësishme.

**H<sub>03</sub>** – Priten dallime të rëndësishme statistikore ndërmjet dy grupeve të fëmijve (13 dhe 14 vjeçare), në variablat antropometrike, motorike bazike dhe vrapimet e distancave të shkurtra si ndryshore motorike specifike.

## **5. METODOLOGJIA E PUNËS**

### **5.1 MOSTRA E TË TESTUARVE**

Në këtë punim janë përfshirë gjithësej 100 nxënës të klasave të nënta të moshës 13 dhe 14 vjeçare gjatë kalendarit shkollor 2018/2019.

Mostrat e të testuarve është përbërë nga dy grupe të nxënësve e SH.F.M.U. "Zejnel Salihu" Fushë Kosovë.

Grupin e parë të nxënësve e përbëjnë 50 nxënës të moshës 13 vjeçare të SH.F.M.U. "Zejnel Salihu" dhe 50 nxënës të moshës 14 vjeçare të SH.F.M.U. "Zejnel Salihu"

Gjithsej janë nxënësve 100 nxënës të rregullt të klasëve tetë dhe nënta të SH.F.M.U. "Zejnel Salihu" në Fushë Kosovë, të gjinisë mashkullore.

Pasi, nxënësit kanë kaluar procedurën paraprake të përzgjedhjes me rastin e evidentimit, është e natyrshme se do të jenë të aftë në aspektin psikofizik që ti nënshtrohen testeve të tilla për qëllimet e këtij punimi.

#### **Kriteri themelor për pjesëmarrje në hulumtim ka qenë:**

- a) që gjatë vitit të kenë qenë të rregullt në orët e edukatës fizike
- b) të kenë qenë të rregullt në procesin mësimorë,
- c) të mos jenë të sëmurë gjatë testimit,

## **5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE**

### **5.2.1. Ndryshoret antropometrike**

Për identifikimin e variablave morfologjike dotë aplikuar këta parametra morfologjik:

1. Lartësia e trupit..... **ALARTË**
2. Gjatësia e krahut.....**AGJAKR**
3. Gjatësia e këmbës.....**AGJAKË**
4. Peshë e trupit..... **APESHA**
5. Perimetri i krahut..... **APERKR**
6. Perimetri i kofshës..... **APERKO**

### **5.2.2 Ndryshoret motorike bazike**

Për identifikimin e aftësive motorike dotë aplikuar këta parametra motorik:

1. Kërcim së gjati nga vendi ..... **MKGJVE**
2. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e djathtë.....**MKGJVD**
3. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën majt.....**MKGJVM**
- 4.Kërcim së larti nga vendi.....**MKLART**
5. Fleksibilitet për kulje e trupit para.....**MFPERP**

### **5.2.3 Ndryshoret motorike specifike**

Për identifikimin e aftësive specifike motorike dotë aplikuar këta parametra:

- 1.Vrapim 40 metra starti ulët.....**MV40SU**
- 2.Vrapimi 60 metra starti ulët.....**MV60SU**



## 5.3 TEKNIKAT E MATJES

### 5.3.1 Teknika e matjeve të karakteristikave antropometrike

**Variablat antropometrike** janë matur sipas mënyrës siç vijon:

**1.Lartësia e trupit (ALARTË)** është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. I testuari drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metalike (rrëshqitësin) ashtu që akrepi horizontal të vendoset në mënyrë të drejtë në majën e kokës. Atëherë lexohet rezultati në shkallën e matjes të antropometrit me saktësi prej 0,1 cm.

**Foto 1. Lartësia e trupit**



**2. Gjatësia e krahut (AGJAKR)** është matur me antropometër të shkurtuar. I testuari qëndron drejt, me dorë dhe shuplakë të shtrirë, lehtësisht të larguar nga trupi. Njëri skaj i antropometrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së majtë, kurse tjetri skaj (aty ku lexohet rezultati) në zgjatimin shpatullor (processus acromialis) të anës së njëjtë. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto 2. Gjatësia e krahut*



**3. Gjatësia e këmbës (AGJAKË)** është matur me antropometër. I testuari duhet të qëndrojë sikurse në matjen e lartësisë së trupit. Matja bëhet nga dyshemeja ku qëndron i eksperimentuari deri në pikën e quajtur “gjembi i sipërm i përparmë i çapokut“ (spina iliaca anterior superior) të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto 3. Gjatësia e këmbës*



**4. Pesha e trupit (APESHA)** është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

*Foto 4. Pesha e trupit*



**5. Perimetri i krahut (APERKR)** është matë me traken matëse prej plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtpëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

*Foto 5. Perimetri i krahut*



**6. Perimetri i kofshës (APERKO)** është matur me shirit milimetrik. I testuari qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme diç të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto 6. Perimetri i kofshës*



### 5.3.2 Teknika e matjeve të aftësive motorike bazike

#### 1. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJVE

Variablat motorike janë ekzekutuar sipas mënyrës siç vijon:

##### 1. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJVE

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

##### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë-qëndrimi me këmbë të kthyer në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

#### 7. Kërcim së gjati nga vendi



## 2. Kërcim nga vendi në gjatësi me të djathtën – MKGJVD

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë qëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

### **8. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e djathtë**





### 3. Kërcim nga vendi në gjatësi me të majtën – MKGJVM

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë qëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

#### **9. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e majtë**



#### 4. Kërcim së larti nga vendi – MKLART

**Instrumentet:** Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me 1 cm.

**Vlerësimi:** lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

#### **Foto 10. Kërcim së larti nga vendi**



## 5. Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) – MFPERP

**Instrumentet:** Banak, metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për dërrase të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron mbi ulësen suedeze, me këmbët drejtë, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

**Realizimi i detyrës:** I e testuari në përkulje të thellë dhe këmbët drejtë, në maje të gishtërinjve të të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. E testuara e mbanë pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë.

**Vlerësimi:** Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

**Udhëzime të testuarës:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.

*Foto 11. Përkulje para*



### 5.3.3 Teknika e matjeve të ndryshoreve specifike motorike

#### 1. Vrapim 40 metra nga starti i lartë – MV40SU

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

**Realizimi i detyrës:** I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e caktuar, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e caktuar.

**Vlerësimi:** Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

**Udhëzime të testuarit:** Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

*Foto 12. Vrapim 40 metra nga starti i ulët*



## 2. Vrapim 60 metra nga starti i lartë – MV60SU

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

**Realizimi i detyrës:** I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e caktuar, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e caktuar.

**Vlerësimi:** Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

**Udhëzime të testuarit:** Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

**Foto 12. Vrapim 60 metra nga starti i lartë**



## 5.4 METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE

Në mënyrë qëkërkimi shkencor të jep rezultate të kënaqshme do të jetë e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komperative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto faktet për qëllimet e këtij hulumtimi do të zgjedhen procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë mënyrën e problemeve që do të hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike do të llogariten vlerat e mëposhtme:

### 1. Parametrat themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetike (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)
- Koeficienti i variacionit (Kv)
- Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)

**2. Distribucioni normal** i rezultateve të fituara nga vlerësimi i ndryshoreve motorike dhe situacionale do të testohet me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit dhe Shaparovit - Wilksit.

**3. Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

**4. Për vërtetimin e dallimeve** ndërmjet dy grupeve 13 dhe 14 vjeç, grupin e nxënësve nga " Zejnel Salihu" dhe grupin e nxënësve nga Shkolla , në parametrat antropometrik, motorike dhe specifike-motorike do të aplikohet analiza e variancës për dy grupet e pavarura, domethënë dallimi në mes grupeve në mesataret aritmetike është realizuar përmes analizës diskriminative T- testit për grupe të pavarura.

## 6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI

### 6.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SPECIFIKE TE FËMIJËT E MOSHËS 13 VJEÇ


Në tabelën 1 dhe Histogramet 1-13 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve psikomotorike, motorike specifike tenxënësit e nxënësve e SH.F.M.U. "Zejnel Salihu" FusheKosove. Mostra ka përfshirë grupin 50 nxënës të gjinisë mashkullore të moshës 13 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Shmngia nga distribucioni normal është testue me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit dhe Shaparovit dhe Wilksit. Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelë.

*Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve natropometrike, motorike bazike dhe motorike specifi ke te nxënëset e moshës 13 vjeçare*

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	KS	SHW	KV
<b>ALARTË</b>	50	140.5	172.5	160.71	8.87	-0.906	0.014	0.002	0	5.52
<b>AGJAKR</b>	50	65	79	74.07	4.27	-0.392	-1.094	0	0	5.76
<b>AGJAKË</b>	50	80	103	93.44	3.83	-0.794	0.399	0.002	0.005	4.1
<b>APESHA</b>	50	31.2	66	50.38	9.27	-0.207	-0.701	.200*	0.204	18.4
<b>APERKR</b>	50	19	27	23.76	2.19	-0.518	-0.409	0	0	9.22
<b>APERKO</b>	50	38	55	46.94	4.06	-0.323	-0.47	0.004	0.131	8.64
<b>MKGJVE</b>	50	140	220	167.4	18.24	0.892	1.068	0.043	0.005	10.89
<b>MKGJVD</b>	50	115	166	140.72	15.12	0.028	-1.295	0.003	0.008	10.74
<b>MKGJVM</b>	50	120	177	142.9	15.36	0.872	0.001	0.012	0.001	10.75
<b>MKLART</b>	50	26	56	39.27	7.97	0.098	-0.986	0.006	0.021	20.31
<b>MFPERP</b>	50	10	37	26.94	6.94	-0.507	-0.445	0.033	0.013	25.75
<b>MV40SU</b>	50	5.51	8.2	6.71	0.59	0.354	0.181	0.034	0.272	8.72
<b>MV60SU</b>	50	8.03	11.41	9.69	0.75	-0.229	-0.291	0.007	0.297	7.77

Mesatarja aritmetikore e matjes të ndryshorës antropometrike, Lartësia e trupit (ALARTË) (Tabela 1 dhe Histogramet 1) është 160.70cm. Rezultati minimal i matjes (140.5cm) dhe atij maksimal (172.5cm) i ndryshorës antropometrike Lartësia e trupit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore ka vlerat më të larta tregon sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtik). Nxënësit e moshës 13vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen (KV=5.52%) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal e që është vërtetuar me anë të koeficientit të Kolmogorovit - Smirnovit (K-S) dhe Shapirovit -Wilksit (Sh-W). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtike.


*Histogrami 1. Histogrami i ndryshorës- Lartësia e trupit*






Mesatarja aritmetikore e matjes të ndryshorës antropometrike, Gjatësia e krahut (AGJAKR) (Tabela 1 dhe Histogramet 2) është 74.07cm. Rezultati minimal i matjes (65.00cm) dhe atij maksimal (79.00cm) i ndryshorës antropometrike Gjatësia e krahut tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore ka vlerat më të larta tregon sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtik). Nxënësit e moshës 13vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen (KV=5.76%) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal e që është vërtetuar me anë të koeficientit të Kolmogorovit - Smirnovit (K-S) dhe Shapirovit -Wilksit (Sh-W). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike.

**Histogrami 2. Histogrami i ndryshorës- Gjatësia e krahut**




Mesatarja aritmetikore e matjes të ndryshorës antropometrike, Gjatësia e këmbës (AGJAKË) (Tabela 1 dhe Histogramet 3) është 93.44cm. Rezultati minimal i matjes (80.00cm) dhe atij maksimal (103.00cm) i ndryshorës antropometrike Gjatësia e këmbës tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore ka vlerat më të larta tregon sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtik). Nxënësit e moshës 13vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen (KV=4.1%) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal e që është vërtetuar me anë të koeficientit të Kolmogorovit - Smirnovit (K-S) dhe Shapirovit -Wilksit (Sh-W). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtike.

**Histogrami 3. Histogrami i ndryshorës- Gjatësia e këmbës**




